

URDHËR
Nr. 19, datë 21.3.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integrimit European, Sekretarit të Përgjithshëm, znj. Daniela Çekani, për autorizimin e shërbimeve brenda vendit, në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.
2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integrimit European, do të ushtrohen për periudhën nga data 21.3.2017 deri në datën 31.12.2017.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimit European, znj. Daniela Çekani.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjoshaj